

Janar - January 2011 / Mars - March 2011

**KONJUKTURA
TREGUES KRYESORË
EKONOMIKË**

**CONJUNCTURE
MAIN ECONOMIC
INDICATORS**

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Indekset e Shifrës së Afarizmit në Volum

Indekset e Shifrës së Afarizmit në Volum për të gjithë aktivitetet e përfshirë në vërtetimin tremujor janë të deflatuar sipas indekseve përkatëse të çmimeve. Ato janë rezultat i vërtetimit tremujor me zgjedhje pranë ndërmarrjeve ekonomike. Fushat përfshirëse të klasifikuara sipas Nomenklaturës së Aktiviteteve Ekonomike, Rev 1.1, janë Industri, Ndërtim, Tregti, Transport & Komunikacion, Shërbime të tjera (Hotele, Informatike, Shërbime Inxhinierike dhe Arkitekturore). Indekset janë vlerësime fillestare me çmime fikse, kundrejt vitit bazë 2005=100 dhe si të tilla janë objekt përditësimi të vazhdueshëm.

Indeksi i volumit të shifrës së afarizmit në tremujorin e parë 2011 arriti 117.6 përqind, kundrejt tremujorit mesatar (2005=100), duke patur një rënie prej 38.5 përqind krahasuar me tremujorin e parë 2010 dhe 22.4 përqind krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

Në Industri krahasuar me tremujorin e mëparshëm shifra e afarizmit e deflatuar ka një rritje prej 0.3 përqind, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë rritja është 16.4 përqind.

Në Industrinë Nxjerrëse krahasuar me tremujorin e mëparshëm ka një rritje prej 19.5 përqind, Industria Përpunuese ka rritje prej 1.7 përqind, ndërsa Sektori i Energjisë paraqitet me rënie 13.5 përqind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm paraqiten me rritje degët e Industrisë Nxjerrëse dhe Përpunuese respektivisht prej 50.4 përqind dhe 28.3 përqind dhe rënie në Energji, elektrike, ujë 14.3 përqind.

Në Ndërtim, volumni i shifrës së afarizmit paraqitet me rënie 26.4 përqind krahasuar me tremujorin e mëparshëm, ndërsa krahasuar me tremujorin e parë 2010 ky aktivitet paraqitet me rritje 9.0 përqind.

Në sektorin e Shërbimeve ku përfshihen aktivitetet ekonomike Tregti, Hotele, Transport, Shërbime Informatike dhe Arkitekturore, në tremujorin e parë 2011 krahasuar me tremujorin e mëparshëm u shënua 18.5 përqind rënie dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm ka një rritje prej 3.4 përqind.

Në Tregti, indeksi paraqitet me rënie 18.5 përqind krahasuar me tremujorin e mëparshëm, ndërsa krahasuar me tremujorin e parë 2010 rritja është 3.9 përqind.

Në Transport dhe Komunikacion në tremujorin e parë 2011 ky tregues paraqet rënie 14.5 përqind krahasuar me tremujorin pararendës dhe rritje prej 0.3 përqind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

OVERALL OUTLOOK

Turnover Volume Indices

Indices of volume of turnover estimated with fixed prices for the all economic sectors included in quarterly survey are deflated by the respective indices of prices. These indices are results of quarterly sample survey near economic enterprises. The economic activities classified by the Nomenclature of Economic Activities Rev 1.1, included in the survey are Industry, Construction, Trade, Transport and Communication, Other services (Hotels, Informatics, and Architectural services). Indices are estimations with fixed prices, against base year 2005=100 and are object of continuous updating.

The index of volume of turnover in the first quarter 2011 was 117.6 percent against the average quarter (2005=100), having a decrease of 38.5 percent compared with the first quarter 2010 and 22.4 percent compared with the previous quarter.

In Industry compared with the previous quarter turnover deflated increased by 0.3 percent, while compared with the same period of the previous year the increase is 16.4 percent.

In Extracting Industry compared with the previous quarter there is an increase of 19.5 percent, Manufacturing Industry increased by 1.7 percent while Energy decreased by 13.5 percent. Compared with the same period of the previous year there is an increase In Extracting Industry and in Manufacturing respectively by 50.4 and 28.3 percent and a decrease in Energy and water of 14.3 percent.

In Construction the index of volume of turnover decreased by 26.4 percent compared with the previous quarter, while compared with the first quarter 2010 this activity increased by 9.0 percent.

In Services where are included Trade, Hotels, Transport and Informatics Services and Architectural Services, in the first quarter 2011 compared with the previous quarter it is noted a decrease of 18.5 percent while compared with the same period of the previous year there is an increase of 3.4 percent.

In Trade, the index decreased of 18.5 percent compared with the previous quarter, while compared with the first quarter 2010 the increase is 3.9 percent.

In Transport and Communication in the first quarter 2011 there is a decrease 14.5 percent compared with the previous quarter and an increase 0.3 percent compared with the same period of the previous year.

FORCAT E PUNËS

Forcat e Punës. Gjatë tremujorit të parë 2011 forca e punës është 1,063,275 persona, ndërsa shkalla e papunësisë së regjistruar është 13.43%.

Numri mesatar i të punësuarve në sektorin privat bujqësor për tremujorin e parë 2011 është 506,664

Numri mesatar i të punësuarve në sektorin privat jo bujqësor është rritur me 4.1% krahasuar me tremujorin e parë të vitit të kaluar.

Numri mesatar i të papunëve të regjistruar gjatë tremujorit të parë 2011 është 142,836 ndërsa numri mesatar i të papunëve që përfitojnë pagesë papunësie është 8,517

Niveli mesatar i ndihmës së pjesshme ekonomike është 3,336 lekë ndërsa niveli i ndihmës ekonomike të plotë është 4,127 lekë.

Paga minimale me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr 566, datë 14/07/2010 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi" është 19,000 lekë.

Niveli bazë i pagesës së papunësisë me VKM Nr 697, datë 18/08/2010 është 6,565 lekë.

LABOUR FORCE

Labor force during the fourth first 2011 is 1,063,275 persons and the registered unemployment rate is 13.43%.

The average number of employed in private agricultural sector for the first quarter 2011 is 506,664 persons.

In the private non-agricultural sector over the first quarter 2011, the average number of employed has increased by 4.1 % compared to the first quarter of the previous year.

The average number of registered unemployed over the first quarter is 142,836 persons. The average number of unemployed who receive unemployment benefit is 8,517

The average amount of partial social assistance per family is 3,336 Albanian LEK whereas the average amount of full social assistance is 4,127 LEK.

The minimum wage level according to the Council of Ministers Decision, No 566 of date 14/07/2010 "For the determination of minimum wage at national level" is 19,000 LEK.

The base level of unemployment benefit according to the Council of Ministers Decision No 697 of date 18/08/2010 is 6,565 LEK.

INDEKSET E ÇMIMEVE

Indeksi i Çmimeve të Konsumit në tremujorin e parë të vitit 2011 arrit në 112.9 përqind kundrejt muajit Dhjetor 2007 (Dhjetor 2007 = 100), duke shënuar një rritje prej 3.9 përqind krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2010 indeksi shënoi një rritje prej 4.4 përqind.

Gjatë këtij tremujori indeksi i grupit " Ushqime dhe pije jo alkolike" shënoi një rritje prej 7.5 përqind kundrejt tremujorit të mëparshëm, ndërsa indeksi i grupit "Pije alkolike dhe duhan" një rritje prej 8.7 përqind.

Indeksi i kushtimit në ndërtim arriti 129.2 për qind në tremujorin e parë 2010 (trem 4 1999 =100) duke shënuar një rritje prej 0.2 përqind krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

Indeksi i çmimeve të prodhimit në tremujorin e parë 2011 ariti 111.8 për qind (2005=100) duke shënuar një rritje prej 1.0 përqind kundrejt tremujorit të mëparshëm.

CONSUMER PRICE

The Consumer Price Index during the first quarter 2011 resulted 112.9 percent against December 2007 (December 2007 = 100), signed an increase by 3.9 percent against the previous quarter. Compared with first quarter 2010 index signed an increase by 4.4 percent

During this quarter the index of the "Food and non alcoholic drinks" groups signed an increase by 7.5 percent compared with previous quarter, and the index of the "Alcoholic beverages and tobacco" signed an increase by 8.7 percent.

The construction cost index resulted 129.2 percent in the first quarter 2011 (fourth quarter 1999 = 100) , signing an increase by 0.2 percent compared with previous quarter.

The producer price index in the first quarter 2011 resulted 111.8 percent, (2005 =100) signing an increase by 1.0 percent compared with previous quarter.

TREGTIA E JASHTME

Eksporti i mallrave gjatë tremujorit të parë të vitit 2011, arriti në 51,772 milion lekë ose 22 përqind më shumë se në tremujorin e katërt të vitit 2010 dhe 46.2 përqind më shumë se në të njëjtin tremujor të vitit të kaluar.

Importi i mallrave gjatë tremujorit të parë të vitit 2011 arriti në 115,920 milion lekë ose 12.2 përqind më pak se në tremujorin e katërt të vitit 2010 dhe 15.6 përqind më shumë se në të njëjtin tremujor të vitit të kaluar.

Përqindja e mbulimit të eksporteve nga importet, në tremujorin e parë të vitit 2011 ishte 44.7 përqind .

Gjatë këtij tremujori 31.6 përqind të totalit të eksporteve dhe 9.7 përqind të importit, e zuri grupi “Teksile dhe këpucë”.

Importi i grupit “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” shënon 19.3 përqind ndaj totalit të importit.

Partnerët kryesorë tregtarë, gjatë këtij tremujori vazhduan të jenë Italia dhe Greqia, me të cilat është kryer respektivisht 29.1 përqind dhe 11.5 përqind e importit dhe 45.6 përqind dhe 4.5 përqind e eksportit.

Me vendet e Bashkimit Europian është kryer 64.3 përqind e eksporteve dhe 66.1 përqind e importeve

FOREIGN TRADE

The export of goods in the first quarter 2011 is 51,772 million lek, or 22 percent more than the previous quarter, and 46.2 percent more, compared with the same period of the previous year.

The imports of goods in the first quarter 2011, is 115,920 million lek or 12.2 percent less than the fourth quarter 2010 and 15.6 percent more than the same period of the previous year.

The percentage of coverage of exports by imports in the first quarter 2011 was 44.7 percent.

In this quarter 31.6 percent of total exports and 9.7 percent of imports were realized by the group “Textiles and Shoes”.

Imports of the group “Machinery and equipments”, singes 19.3 percent of total imports.

The main trade partners remain Italy and Greece, whose exports and imports with our country represent respectively 29.1 percent and 11.5 percent of imports and approximately 45.6 percent and 4.5 percent of exports.

With the countries of European Community there is performed about 64.3 percent of exports and 66.1 percent of imports.

Fig.1 Tregtia e Jashtme
Foreign trade




Fig.2 Eksporti tekstile dhe këpucë
Export of textiles and footwear




Fig.3 Eksporti i ushqime, pije, duhan
Export of food, beverages and tobacco



Fig.4 Importi makineri e pajisje
Import of machinery and equipment



Fig .5 Kursi i Këmbimit
Exchange rate




Fig.6 Ndryshimi i IÇK me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm

Change of CPI with the same period of the previous year




Fig.7 Konsumi i Energjisë Elektrike nga familjet

Consumption of electricity residential sector





Fig.8 Konsumi i dukshëm i çimentos

Apparent consumption of cement



TREGUES KRYESORË EKONOMIKË

Treguesit Kryesorë	Njësia matëse	I - 08	II - 08	III - 08	IV - 08	I - 09	II-09	III-09	IV-09
INDEKSI I VOLUMIT TË SHIFRËS AFARIZMIT * (Periudha bazë 2005=100)									
	%								
Prodhim dhe Shërbime		111.8	119.1	136.2	146.0	142.3	146.0	158.1	158.2
Prodhim (Industri dhe Ndërtim)		113.5	137.4	146.0	158.9	157.1	179.6	180.6	186.4
Industry		112.4	130.3	133.3	127.5	132.9	135.5	144.7	153.6
Industria Nxjerrëse		117.6	177.3	147.3	109.5	87.5	128.0	154.7	143.8
Industria Përpunuese		109.7	132.1	138.8	131.0	131.4	140.3	144.7	151.4
- Ind. Ushqimore, Duhan, Pije		107.4	139.8	148.0	146.2	114.2	134.7	154.5	153.3
- Ind. Tekstile e veshje		108.9	112.6	90.6	102.7	111.2	105.6	92.7	109.0
- Ind. Lëkure këpucëve		90.5	89.1	79.1	82.8	104.3	128.1	141.9	139.1
- Punime me dru, fab. Artikujve me dru		104.1	89.4	108.9	120.2	111.1	142.4	131.3	165.6
- Ind. Letrës, kartonit, botime		124.2	122.5	130.3	140.1	100.0	129.3	139.6	156.3
- Rafinimi, Ind. Kimike, Kauçukut e plastikës		74.6	110.9	122.5	101.7	179.2	161.6	107.5	134.7
- Fab. i artikujve minerale jo- metalike		130.3	141.7	154.3	151.9	138.4	194.1	212.2	203.8
- Metalurgjia, Fab. Makinave, paisjeve,		140.0	170.2	180.1	157.1	105.3	76.7	135.2	126.1
Paisjeve elektrike elektronike, Mjeteve të transportit									
- Ind. Të tjera përpunuese		78.3	84.5	102.6	92.6	71.4	76.5	81.4	97.6
Energji Elektrike, Gaz, Ujë		115.1	109.0	110.7	119.1	148.7	121.4	138.3	160.0
- Electricity		115.0	108.6	109.1	119.3	152.1	121.8	140.3	163.8
- Water supply		112.6	110.0	122.5	114.4	116.2	115.4	118.1	124.6
Ndërtimi		114.8	146.8	162.8	201.0	193.8	250.6	237.1	237.2
Shërbime		110.1	109.1	130.8	138.9	134.1	128.3	145.8	142.9
- Tregti		110.6	108.5	129.2	141.5	129.8	121.8	138.4	137.7
- Transport, Komunikacion		111.1	110.7	138.8	126.5	143.6	144.4	171.7	163.6
- Hotele		103.1	114.1	142.9	108.6	82.3	110.8	131.5	104.6
TREGTIA E JASHTME									
Eksporti (FOB)	mIn/lekë	25,546	31,860	29,502	25,665	22,107	25,445	26,361	29,076
- Rieksporetet (Përpunim aktiv)	mIn/lekë	17,852	17,943	15,002	16,573	15,980	16,137	15,229	5,774
Importi (CIF)	mIn/lekë	97,247	107,908	110,189	124,548	94,713	106,671	111,163	118,397
Bilanci tregtar	mIn/lekë	-71,701	-76,048	-80,687	-98,883	-72,606	-81,226	-84,802	-33,324
% e mbulimit (Ex/Im)	%	26.3	29.5	26.8	20.6	23.3	23.9	24.0	23.0
TREGUES SË KËRKESËS SË BRENDSHME									
Konsumi i energjisë. elektr. nga familjet	mIn/Kwh	678	513	517	582	678	540	558	647
Konsumi i dukshëm i karburanteve	mIn/hektolitra	1,392	1,430	1,398	1,645	1,302	...	...	...
Importet e autoveturave gjithsej	numër	4,111	4,397	4,772	5,120	4,802	4,456	4,689	7,443
Exportet Tekstile dhe kepucë	mIn/lekë	12,809	12,827	11,248	11,928	12,191	11,887	11,711	12,394
INVESTIMET									
Importet e makineri paisje	mIn/lekë	21,500	21,555	22,246	31,454	23,999	26,170	23,298	25,452
Konsumi i dukshëm i cimentos	ton	403,679	423,109	443,306	491,387	422,327	654,025	673,077	508,739

1 *Indekset janë të përditësuar

*The indices are updated

- Epaaplikueshme

- Not aplicable

I - 10	II - 10	III - 10	IV - 10	I - 11	01-11	02-11	03-11	Unit of measure	Main Indicators
									TUNOVER VOLUME INDEX (Base period (2005=100))
									%
151.6	175.7	185.9	191.2	117.6					Production and Services
176.7	212.6	209.4	220.5	197.6					Production (Industri and Construction)
175.3	200.9	196.6	203.4	204.1					Industry
170.1	186.3	211.4	214.1	255.8					Extracting Industry
136.2	165.3	179.7	171.8	174.7					Manufacturing Industry
114.5	156.9	181.4	156.6	130.7					- Food industry
129.5	123.4	115.9	120.9	134.9					- Textile and dressing industry
154.4	147.8	155.9	136.8	153.3					- Leather and shoes industry
127.3	137.6	130.2	160.1	148.3					- Wood industry
237.8	233.7	366.7	384.0	251.0					- Paper and publication industry
95.2	96.2	98.5	70.2	133.8					- Refined and coke, Chemical, Plastic industries
158.0	225.2	240.4	223.8	203.8					- Other non-metalic mineral ind.
130.0	175.1	171.3	189.8	198.6					- Machinery and equipment, Electric & electronic equipment manufacturing
65.9	77.3	91.9	95.5	56.0					- Other procesing industry
299.6	317.0	239.2	296.9	256.8					Electricity, gas and water supply
324.9	341.2	251.0	318.0	275.4					- Electricity, gas
110.8	135.0	146.5	137.0	117.2					- Water supply
153.3	208.0	208.1	226.9	167.1					Construction
138.5	156.9	172.8	175.6	143.2					Services
134.7	153.6	168.6	172.8	139.9					- Trade
142.5	154.0	173.4	167.1	142.9					- Transport and Communication
97.6	118.3	175.7	125.4	96.3					- Hotels
									FOREIGN TRADE
35,423	46,713	36,928	42,441	51,772	14,770	20,049	16,953	mln/lek	Ex ports (FOB)
20,330	21,855	20,473	22,662	23,706	6,919	7,881	8,907	mln/lek	- Re-exports (Inward Processing)
100,284	120,563	125,783	132,078	115,920	35,201	37,733	42,986	mln/lek	Imports (CIF)
-64,861	-73,850	-88,855	-89,637	-64,148	-20,431	-17,684	-26,033	mln/lek	- Trade balance
35.3	38.7	29.4	32.1	44.7	42.0	53.1	39.4	%	% of coverage (Ex/Trade Imp.)
									INDICATORS OF DOMESTIC DEMAND
713	536	595	743	714	249	240	225	mln/lkwh	Residential sector
	...	...	...	...				mln/hectoliter	Apparent consumption of fuels
4,026	4,371	3,892	3,965	2,792	858	902	1,032	number	Total imports of cars
13,892	11,381	13,888	13,902	16,343	5,140	5,444	5,759	mln/lek	Ex port of textile and shoes
									INVESTMENTS
19,844	24,125	23,792	25,254	22,315	6,816	6,953	8,546	mln/lek	Imports of machinery and equipment
408,393	363,308	321,161	171,958	224,677	69,778	76,433	78,466	ton	Apparent consumption of cement

TREGUES KRYESORË EKONOMIKË

Treguesit Kryesorë	Njësia matëse	I - 08	II - 08	III - 08	IV - 08	I - 09	II-09	III-09	IV-09
INDEKSET E ÇMIMEVE									
Ndryshimi i IÇK me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm	%	3.7	4.2	2.9	2.5	1.9	2.1	2.5	2.9
Indeksi i çmimeve të konsumit (Dhjet. 07=100)	%	100.5	101.1	100.34	101.60	103.31	102.47	102.50	104.50
- Ushqimore, e pije jo alkolike	%	101.0	100.8	98.20	101.80	106.55	103.53	103.50	107.6
- Pije alkolike dhe duhan	%	100.0	100.1	100.60	101.80	103.23	103.93	103.90	106.2
- Tarifat publike	%	100.0	114.7	120.1	122.7	122.78	123.33	123.30	123.8
Indeksi i kushtimit në ndërtim (Tr.IV 99=100)	%	127.3	128.3	128.8	129.0	128.47	128.4	128.3	128.4
- Shpenzime materiale	%	129.9	131.8	132.7	132.4	130.92	130.60	130.30	130.4
Indeksi i çmimeve të prodhimit (v.2005=100)	%	109.5	111.5	111.7	111.1	108.80	108.6	109.4	110.1
TREGU I PUNËS									
Forcat e punës	numër	1,080,107	1,105,932	1,109,968	1,115,562	1,114,161	1,114,166	1,113,580	1,042,618
- Të punësuar	numër	939,298	965,915	969,893	974,067	972,851	972,831	971,518	899,278
a) Në sektorin shtetëror	numër	166,750	166,589	166,549	166,543	166,563	166,453	166,453	166,250
b) Në sektorin privat jo bujqësor	numër	230,548	230,777	234,795	238,975	237,739	237,829	236,516	236,838
c) Në sektorin privat bujqësi	numër	542,000	568,549	568,549	568,549	568,549	568,549	568,549	496,190
- Të papunë	numër	140,809	140,017	140,075	141,495	141,310	141,335	142,062	143,340
- Përfitojnë pagesë papunësie	numër	8,894	9,077	9,591	9,916	8,238	8,485	9,268	10,050
Shkalla e papunësisë së regjistruar	%	13.04	12.97	12.62	12.68	12.68	12.70	12.76	13.75
TË ARDHURAT									
Paga mesatare mujore në sek. shtetëror	lekë	35,800	35,943	36,093	38,310	39,396	40,100	42,000	42,000
Paga bazë minimale mujore	lekë	16,000	16,000	17,000	17,000	17,000	18,000	18,000	18,000
Niveli baze i pagesës mujore të papunësisë	lekë	5,980	5,980	5,980	5,980	5,980	5,980	6,340	6,340
Ndihma ek. mesatare mujore për një familje	lekë								
- ndihmë e plotë	lekë	3,200	3,217	3,405	3,798	3,899	3,746	3,900	3,900
- ndihmë e pjesshme	lekë	2,356	2,505	2,518	2,986	3,079	3,114	3,135	3,150
FINANCAT SHETËRORE									
Të Ardhurat	mln/lekë	63,619	71,371	74,033	81,156	72,214	72,958	76,014	47,009
Shpenzimet	mln/lekë	53,214	84,106	80,054	130,123	76,042	102,201	91,619	62,787
% e mbulimit të shpenzimeve	%	119.55	84.86	92.48	62.37	94.97	71.39	82.97	74.87
KURSI MESATAR I KËMBIMIT									
Lekë/USD	lekë	82.53	78.23	81.33	93.47	98.59	92.01	92.01	92.91
Lekë/EURO	lekë	123.63	122.26	122.12	123.20	128.21	131.22	131.54	137.26
MASA MONETARE									
Masa monetare (M3)	mln/lekë	754,514	773,699	820,363	815,599	805,368	819,399	843,628	871,470
NORMA E INTERESIT VJETOR									
- Norma e depozitave (12 M)	%	6.57	6.59	7.55	6.26	6.73	6.78	6.78	6.79
- Norma e kredisë (12 M)	%	13.79	11.94	11.54	11.76	12.98	12.27	12.27	12.46
Norma e interesit të letrave me vlerë									
- Norma e BTH 3-M	%	6.25	6.28	6.24	6.16	6.12	6.32	6.32	6.33
- Norma e BTH 6-M	%	7.36	7.47	7.39	7.36	7.51	7.68	7.68	7.63
- Norma e BTH 12-M	%	8.02	8.16	8.13	8.20	8.93	9.29	9.29	9.29

MAIN ECONOMIC INDICATORS

I-10	II-10	III-10	IV-10	I-11	01-11	02-11	03-11	Unit of measure	Main Indicators
PRICES									
4.0	3.8	3.4	3.3	4.4	3.3	4.5	4.3	%	Change of CPI with the same period of the previous year
107.40	107.1	106.0	107.9	112.1	110.5	113.0	112.9	%	Consumption price index (Dec.07=100)
113.80	111.8	107.9	112.0	120.4	116.8	122.6	121.7	%	- Food and non-alcoholic beverages
107.53	109.1	110.9	112.1	121.8	120.0	122.6	122.7	%	- Alcoholic beverages and tobaccos
129.80	135.3	135.4	136.1	136.1	135.9	136.2	136.3	%	- Public tariffs
128.60	128.7	128.9	129.0	129.2				%	Construction cost index (Tr. IV 99 =100)
130.80	131.0	131.3	131.5	132.0				%	- Raw materials
108.53	108.9	109.8	110.7	111.8	111.8	111.8	111.9	%	Product price Index (Year 2005=100)
EMPLOYMENT									
1,045,261	1,049,491	1,059,199	1,059,959	1,063,275				number	Labor force
900,653	904,850	915,981	916,919	920,439				number	Employment
166,250	166,500	166,600	166,000	165,400				number	a) Public sector
238,213	242,160	242,717	244,255	248,375				number	b) Non agricultural private sector
496,190	496,190	506,664	506,664	506,664				number	c) Agricultural private sector
144,608	144,641	143,218	143,040	142,836	142,792	142,962	142,755	number	Unemployment
9,853	10,775	10,205	9,509	8,517	8,628	8,572	8,351	number	- Receiving unemployment benefit
13.83	13.78	13.5	13.49	13.43				%	Registered unemployment rate
INCOMES									
42,000	42,800	44,700	45,000	45,400				lek	Average monthly wage in state sector
18,000	18,000	19,000	19,000	19,000				lek	Minimum monthly wage approved
6,340	6,340	6,565	6,565	6,565				lek	Monthly unemployment basic benefits
								lek	Monthly family social assistance
3,690	3,940	3,980	4,023	4,127				lek	- full payment
3,169	3,169	3,200	3,325	3,336				lek	- partial payment
PUBLIC FINANCE									
72,672	77,340	83,437	56,478	77,535	27,006	22,138	28,391	mln/lek	Revenues
76,858	94,180	91,753	55,619	89,311	25,385	32,663	31,263	mln/lek	Expenditures
94.55	82.12	90.94	101.54	86.81	106.39	67.78	90.81	%	% coverage of expenditures
AVERAGE EXCHANGE RATE									
100.23	107.88	105.68	101.96	102.09	103.84	102.27	100.17	lek	Leks/USD
138.76	137.24	136.47	138.67	139.46	138.65	139.59	140.14	lek	Leks/EURO
BROAD MONEY									
887,868	902,316	948,374	980,284	983,505	981,424	978,045	983,505	mln/lek	Broad money (M3)
ANNUAL INTEREST RATES									
6.70	6.48	6.32	6.18	5.89	5.98	5.89	5.8	%	- Interest rate on deposits in Lek (12 M)
12.39	12.37	10.45	11.82	11.68	11.7	11.52	11.81	%	- Interest rate for lending in Lek (12 M)
Securities rates									
6.25	5.93	5.73	5.51	5.28	...	5.21	5.35	%	- T-Bills rate 3 M
7.44	7.19	7.04	6.64	6.47	6.32	6.38	6.72	%	- T-Bills rate 6 M
8.84	8.12	7.85	7.45	7.02	6.83	6.95	7.27	%	- T-Bills rate 12 M

SHËNIM METODOLOGJIK

Treguesit kryesorë ekonomikë të konjunkturës shërbejnë si burim të dhënash për njohjen e tendencave të zhvillimit të përgjithshëm të situatës ekonomike në vendin tonë. Përdoruesit e të dhënave makroekonomike do të gjejnë në këto publikime më shumë tendencat kryesore të zhvillimit të ekonomisë që lidhen me prodhimin industrial, tregtinë e jashtme, konsumin, çmimet, punësimin, etj., se sa nivelet absolute të tyre. Në disa raste mund të ketë ndryshime të shifrave operative të raportuara në periudhat e mëparshme, për shkak të saktësisimit të tyre statistikor.

Sqarimet e mëposhtme, dhe përkufizimet në aneksin metodologjik do të lehtësojnë interpretimin e tabelës dhe grafikëve statistikorë të paraqitur me dhënien e indekseve dhe treguesve, bazuar në nomenklaturat e përdorura.

INDEKSET E VOLUMIT TË SHIFRËS SË AFARIZMIT

Këto indekse matin ndryshimet në kohë të volumit të shitjeve të ndërmarrjeve. Krahasuar me periudhë bazë 2005=100 dhe shprehet në përqindje. Indekset llogariten për të gjitha ndërmarrjet që janë subjekt vërtetimi tremujor me zgjedhje, sipas fushave të përcaktuara dhe kodifikuara sipas Nomenklaturës së Veprimtarisë Ekonomike (NVE).

Vlera e shifrës së afarizmit deflatohet me Indekset përkatëse të çmimeve, për të mënjeluar efektin e ndikimit të çmimeve. Rezultatet janë përgjithësuar në nivel ekonomie, duke përdorur peshat e shifrës së afarizmit në Anketën Strukturore pranë Ndërmarrjeve.

TREGTIA E JASHTME

Eksporti (FOB) paraqet vlerën e eksportit të mallrave me origjinë kombëtare si dhe eksportet e mallrave me lëndë të parë të importuar. Në këtë tregues nuk përfshihen mallrat tranzite dhe eksportet e përkohshme (si ekspozitat, të cilat nuk pësojnë ndryshime dhe kthehen përsëri në vendin e origjinës).

Importi (CIF) paraqet vlerën e importeve të mallrave për konsum të brendshëm si dhe importet e mallrave për përpunim të mëtejshëm në vend me qëllim eksportimi. Në këtë tregues nuk përfshihen mallrat tranzite dhe importet e përkohëshme.

Përqindja e mbulimit tregon përqindjen e mbulimit të importeve nga eksportet.

Riekspani paraqet eksportin e mallrave pas përpunimit aktiv (me fason)

TREGUES TË KËRKESËS SË BRENDSHME

Në kushtet e mungesës së informacioneve direkte për treguesit e elementëve të ndryshëm makroekonomikë si konsumi, investimet, etj. kemi konsideruar si tregues të konsumit të dukshëm dhe investimeve:

METODOLOGICAL NOTE

Short term economic indicators are used as a main source of data to understand the trend of general development of the economic situation in our country. In this publication, the users of macroeconomic data will find mainly the trends of economic development concerning industrial output, foreign trade, consumption, prices and employment rather than absolute values. In some cases the data may be corrected, in respect to previous periods, because of the statistical adjustment.

The definitions, which are included in the methodological annexes and the notes below are designed to facilitate the interpretation of statistical tables and graphs.

INDEX OF SALES

Turnover Volume Indices is used to assess current developments in sales and for analysis of short term evolution. Base period is 2005=100, expressed in percentage. Indices are calculated for all enterprises which are the subject of quarterly sample survey, by coverage and codifying by NACE Rev.1.1 classification.

The value of turnover is deflated with the price indices eliminating the price effect. The results are generalized in economy level, using the turnover weights from Annual Structure Survey.

FOREIGN TRADE

Exports (FOB) express the total export of domestic goods and exports of good produced with imported raw materials. From this indicator are excluded the transit goods and temporary exports (like exhibitions, which are turned back without changes). In this publication we have referred to the the Harmonised System (HS) in Import - Exports figures.

Imports (CIF) express the total import of goods for domestic consumption and import of goods, which are processed for being re-exported. From this indicator are excluded the transit goods and temporary exports.

The percentage of coverage shows the rate of coverage of imports by exports.

Re-export shows the export of goods after the inward processing.

INDICATORS OF DOMESTIC DEMAND

Due to the lack of direct information related to the different macroeconomic elements, such as consumption, investments, etc., we have considered as macroeconomic elements following:

Konsumi i energjisë elektrike nga familjet: përfshin konsumin e energjisë elektrike vetëm për popullatën sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Energjitikës.

Konsumi i dukshëm i karburanteve, (vajguri, benzinë, gazoil) përftohet si shumë e prodhimit dhe importit minus eksportin, duke konsideruar zero ndryshimin e gjëndjeve në fund të periudhës.

Importet e autovekurave, televizorëve dhe makina larëseve paraqesin importet në numur sipas përkatësisë të regjistruara në deklaratat doganore.

Importet e makineri paisjeve tregojnë vlerën e importeve të makinerive dhe paisjeve.

Konsumi i dukshëm i çimentos, (përftohet si shumë e prodhimit dhe importit, minus eksportin e çimentos, duke konsideruar zero ndryshimin e gjëndjeve në fund të periudhës.

INDEKSET E ÇMIMEVE

Inflacioni mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të konsumit ndërmjet periudhës korente me njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Indeksi i çmimeve të konsumit (IÇK), mat ndryshimet në kohë të çmimeve të konsumit të një shporte fikse mallrash e shërbimesh, krahasuar me një periudhë bazë, që në rastin konkret është Dhjetor 2007 = 100.

Tarifat Publike janë pagesa të fiksuara nga qeveria si pagesat për ujë, energji elektrike, vajguri, autobus urban, trena, pulla, telefona dhe libra shkollore.

Indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP), mat ndryshimin mesatar të çmimeve të shitjes të produkteve të prodhuara nga prodhuesit e brëndshëm në pikën e parë të shitjes. Në çmimin e prodhimit përfshihen kosto e produktit, marzhi i fitimit dhe përjashtohen taksat e akcizës, taksa e vlerës së shtuar dhe kosto e transportit. Periudha bazë e llogaritjes së indeksit është viti 2005=100.

Indeksi i kushtimit në ndërtim (IKN), mat ndryshimin e shpenzimeve për ndërtim duke marrë në consideratë ndryshimin e çmimeve të imputeve kryesore (materiale ndërtimi, makineri ndërtimi, shpenzime për fuqinë puntore). Periudha bazë është tremujori IV vitit 1999 =100.

TREGU I PUNËS

Forcat e punës (popullsia ekonomikisht aktive) përbëhet nga të punësuarit dhe të papunët e regjistruar.

Të punësuar, janë personat në moshë pune që gjatë periudhës së referencës kanë patur një punë si të punësuar me pagë ose si të vetepunësuar. Përfshihen edhe personat që kanë një punë por që kanë munguar përkohësisht në punë gjatë periudhës që shqyrtohet, për motive si sëmundje, training, leje lindjeje etj.

Residential sector, which includes only the consumption of electric power by population, based on the data provided by the General Directorate of Energy.

The apparent consumption of fuels, which is calculated as sum of the domestic production and imports minus exports of fuels (considering as zero the change in stocks at the end of the period).

The import of cars, TV sets and washing machines, which represent the import in number as registered in the custom declarations.

The import of machineries and equipment, which shows their total value.

The apparent consumption of cement, which is calculated as the sum of domestic production of the cement and imports minus exports of cement (considering zero the change in stock at the end of the period).

INDICES OF PRICES

The annual rate measures the change of the index of consumer prices between one period to the same period of the previous year

The consumer price index, (IÇK) measures the changes of consumer prices of a fixed basket of goods and services, compared with a base period December 2007 = 100.

Public tariffs are the payments fixed by the government to be paid from the population for the consumption of water, electricity, fuels, telecommunication services and school- books.

The producer price index (PPI), measure the average changes of the prices of products at the first point of sale after production. In the price of production are included all applicable discounts and surcharges. Excise taxes, VATs, transportation cost and other distribution costs are excluded. The base year is 2005 = 100.

Construction cost index measures the changes of construction expenditures considering the changes of prices of main inputs (construction materials, construction machinery, expenditures for labor force) prices in different elements of cost during the time. The base period is the fourth quarter of the year 1999 =100.

LABOUR MARKET

Labour force (economically active population) include employed and registered unemployed persons.

Employed are all the persons at working age who, during the reference period, were in the following categories: "paid employment" or "self-employment". Included, are also persons with a job but temporarily not at work during the reference period for reasons as illness, training, maternity leave etc.

Për punësimin në **sektorin shtetëror** të dhënat bazohen në informacionin e grumbulluar nga INSTAT në përputhje me Programin e Statistikave Zyrtare.

Për punësimin në **sektorin privat jobujqësor** si burim është përdorur informacioni i mbledhur nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe nga burime të tjera informacioni si Regjistri i Ndërmarrjeve (mbajtur në INSTAT bazuar në të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-Taksave) dhe Sigurimet Shoqërore.

Numri mesatar i të punësuarve në **sektorin privat bujqësor** nga tremujori i tretë 2008 deri në tremujorin e tretë 2009 është vlerësuar sipas Anketës së Forcës së Punës 2007, nga tremujori i katërt 2009 deri në tremujorin e dytë 2010 është vlerësuar sipas Anketës së Forcës së Punës 2008, dhe nga tremujori i tretë 2010 është vlerësuar sipas Anketës së Forcës së Punës 2009.

Të papunë të regjistruar, konsiderohen të gjithë personat në moshë pune që gjatë periudhës referuese plotësojnë njëherazi tre kriteret: nuk kanë një punë, kërkojnë punë (janë të regjistruar në Zyrën e Punësimit) si dhe janë të gatshëm për punë. Të dhënat për papunësinë e regjistruar mbështeten në informacionin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Shkalla e papunësisë është raporti në përqindje i numrit të të papunëve të regjistruar ndaj forcave të punës.

Përfitues të pagesës së papunësisë. Në këtë kategori përfshihen të gjithë personat që sipas ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", (neni 53), përfitojnë pagesë papunësie.

Sipas këtij ligji personat e siguruar përfitojnë të ardhura papunësie, në rast se:

- Kanë kontribuar në sigurimin shoqëror për jo më pak se 12 muaj
- Janë vërtetuar nga zyra kompetente e punës që janë:
 - të papunë
 - që pranojnë të kualifikohen ose të rikualifikohen
- Nuk marrin përfitime të tjera nga ky ligj, me përjashtim të pensionit të pjesshëm të invaliditetit.

Paga mesatare në sektorin shtetëror (buxhetor dhe jo buxhetor) është shpërblimi që merr çdo punonjës për punën që ka kryer. Ajo përbëhet nga pagesa për punën e kryer, shtesa për funksionin dhe për vjetërsinë në punë, pa zbritur kontributet personale dhe tatimin mbi të ardhurat.

Paga minimale e miratuar është pagë minimale mujore e përcaktuar me V.K.M.nr. 566 datë 14.07.2010 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi".

Pagesa e papunësisë. Sipas ligjit Nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" neni 54, pagesa e papunësisë është një shumë bazë që siguron të paktën një nivel jetese minimale e cila indeksohet çdo vit me indeksin e çmimeve të konsumit dhe që e përfitojnë vetëm personat që kanë humbur vendin e punës. Kjo pagesë zgjat 12 muaj. Masa e pagesës mbështetet në VKM nr.697 dt.18.08.2010 "Për caktimin e nivelit bazë të së ardhurës nga pagesa e papunësisë".

For employment in the **state sector**, data are collected through the Official Statistical Programme implemented by INSTAT.

For employment in the **non-agricultural private sector** are used data based on the information provided by Ministry of Labour, Social Affairs and Equal Opportunities and from other sources of information like Business Register (kept in INSTAT based on the data from The General Tax Authority), and from Social Insurance Institute.

The average number of employed in the **private agricultural sector** from third quarter 2008 till third quarter 2009 is estimated by Albanian Labour Force Survey 2007, from fourth quarter 2009 till second quarter 2010 is estimated by Albanian Labour Force Survey 2008 and from third quarter 2010 is estimated by Albanian Labour Force Survey 2009.

Registered unemployed are considered all persons at working age that during the reference period met the following three criteria: he/she is "without work", is "seeking work" (he/she is registered in the Labour Office) and is "currently available for work". Data about registered unemployed persons are based on the information from provided by Ministry of Labour, Social Affairs and Equal Opportunities.

Unemployment rate expresses the ratio of total registered unemployed over the labour force.

Persons who profit unemployment benefits. This group includes all persons, who according to the Law No.7703, dated 11.05.1993, "For social security in the Republic of Albania", (article 53), profit unemployment benefits.

They profit unemployment benefits if:

- They have contributed in the social security scheme for at least 12 months.
- The labour office verifies that they:
 - are actually unemployed persons;
 - are available to be trained or retrained;
- Do not profit other benefits from this law, except partial invalidity pension.

Average monthly wage is the gross wage of an employee in public sector. This is constituted by basic wage for job performed, additional payment for managerial duties and for years at work, include social security contributions and taxation on income .

Approved minimum wage, is the official minimum wage, approved by the Government Decision No. 566 dated 14.07.2010 "For determination of minimum wage at national level ".

Unemployment benefits. According to the law No.7703, dated 11.05.1993, "For the Social Security in the Republic of Albania", article no.54, unemployment benefit is the amount of money that provides at least a minimum standard of living and is indexed annually with the consumer price index. The unemployment benefit is given only to the employees who have lost their jobs. The duration of unemployment benefit is one year. The amount is based on Government Decision No.697 dated 18.08.2010.

Ndihma ekonomike është një ndihmë në para për familjet e varfra dhe shpërndahet çdo muaj. Ajo mund të jetë e pjesshme ose e plotë në varësi të të ardhurave të familjes.

Social Assistance is a cash benefit for poor families which is distributed every month. It may be partial or full according to the family incomes.

Ndihma ekonomike mesatare për një familje në ndihmë të plotë apo të pjesëshme, llogaritet si raport i fondit të ndihmës së plotë apo të pjesëshme ndaj numrit përkatës të familjeve që e marrin atë.

Average social assistance per family in full or partial social assistance, is calculated as the ratio between the fund of full or partial social assistance with the corresponding number of families that receive it.

FINANCAT SHETETËRORE

PUBLIC FINANCE

Shpenzimet e buxhetit të shtetit përfshijnë shpenzime korente dhe shpenzime për zhvillim. Në shpenzimet korente përfshihen shpenzimet e personelit, shpenzimet operative, interesat, subvencionet, sigurimet shoqërore. Në shpenzimet për zhvillim paraqiten kryesisht investimet.

Expenditures include the total state budget expenditures: current expenditures and investment expenditures. The first group (current expenditures) includes the personnel expenditures, employees compensations, social security payments, subsidies, interest rates and other expenditures. The second group (investment expenditures) includes mainly investments.

Të ardhurat e buxhetit të shtetit përfshijnë si të ardhurat tatimore dhe jotatimore, të ardhurat nga taksat, sigurimet shoqërore si dhe nga fondi kundërparti i krijuar nga shitja e ndihmave.

Revenues include the revenues of the state budget, such as tax incomes, social security incomes, non-tax incomes and counterpart aid incomes.

Përqindja e mbulimit të shpenzimeve është raporti i të ardhurave me shpenzimet dhe tregon përqindjen e mbulimit të shpenzimeve të buxhetit të shtetit me të ardhurat.

The coverage in percent of expenditure is the ratio between expenditures and revenues, and shows the percentage covering of the state budget expenditures from the revenues.

Kursi i këmbimit është kursi zyrtar mesatar i këmbimit të lekut me dollarin dhe euron marrë nga Banka e Shqipërisë.

The exchange rate in lek is the average exchange rate on the inter-bank market, of dollar and euro calculated by the Bank of Albania.

Masa monetare (M3) përfshin paratë në qarkullim jashtë bankave dhe depozitat pa afat dhe me afat si dhe ato në valutë të familjeve, të sektorit privat dhe të sektorit publik.

Broad money (M3) covers money in circulation outside banks, demand and time deposits in leks and in foreign currency of households, state and private sector

Norma e depozitave dymbëdhjetë mujore tregon normën mesatare të peshuar për depozitat e reja (në lekë) gjatë muajit përkatës, me këtë maturim.

Deposits rate represents the interest rate for deposits (in lek) with 12-m maturity.

Norma e huasë dymbëdhjetë mujore tregon normën mesatare të peshuar të huave të reja (në lekë) gjatë muajit përkatës, me këtë afat maturimi.

Lending rate represents the interest rate (in lek) for loans with 12-m maturity.

Norma e bonove të thesarit (yield-i) me maturim tremujor, gjashtëmujor, dhe dymbëdhjetë mujor japin yeld-in mesatar të peshuar të pranuar në ankandin e fundit të periudhës të bonove të thesarit.

Securities rates is the average rate of accepted bids in the last TB auction for the period

Mesatare levizese përdoret në seritë kohore për të zbutur luhatjet afatshkurtra.

Moving average is used with time series data to smooth out short term fluctuations.

Shpjegimi i simboleve

0 = vlerë e vogël
- = nuk ka aktivitet
... = jo i disponueshëm

Explanation of Symbols

0 = small value
- = non-occurrence
... = not available

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Blv. "Zhan d'Ark" , Nr.3, Tiranë / Albania
Tel: + 355 4 2222411 / 2233356
Fax: + 355 4 2228300
e-mail: botim_difuzion@instat.gov.al
marketing@instat.gov.al
www.instat.gov.al